

AKTI I THEMELIT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Optika KOOA" SH.P.K.
DATË 01.12.2022

Sot, në datën 01.12.2022, znj. **Albana Çule**, shtetase shqiptare, lindur më 25.02.1974, në Korçë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H45225035G dhe znj. **Erjola Isa**, shtetase shqiptare, lindur më 08.10.1990 në Korçë, mbajtëse e letërnjoftimit numër personale J06008091R në cilësinë e Ortakeve Themelues, vendosen të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar "**Optika KOOA**" **Sh.P.K.** Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin, i cili i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi, si Shtojca A.

NENI 1 – EMËRTIMI

- 1.1 Shoqëria emërtohet "**Optika KOOA**" Shpk (në vijim "**Shoqëria**").

NENI 2 – FORMA

- 2.1 Shoqëria "**Optika KOOA**" Shpk themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 3 – SELIA

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Bulevardi Republika, Nr.pasurie 1/1041-N2, vol.38, faqe 238, Zone kadastrale 8562, Korçë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresa të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresa sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.


NENI 4 – OBJEKTI

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston në kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara më poshtë:
- Tregtim me shumice e pakice si: syze optike, syze dielli, lente optike, lente kontakti, lente kozmetike, xhamave për syze optike dhe dielli, proteza okulare, aparatura dhe materiale ndihmese për ekzaminim mjekësor import eksport, etj
- Ofrimi i shërbimit të vizitave optometrike/okulistike për të gjitha moshat.
- Shoqëria për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, bashkëpunon dhe ndermjetëson, me persona juridike e fizike, që kanë të njëjtin objekt veprimtarie ose të ngjashëm me të.

NENI 5 – KOHËZGJATJA

- 5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT



- 6.1. Kapitali i Shoqërisë është 100ALL (njëqindlekë), i përbërë nga 2 (dy) kuota secila në pronësi të Ortakeve.
- 6.2 Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht si më poshtë vijon:
- **Albana Çule**, e cila ka shlyer kontributin në Shoqëri, në para në shumën e barabartë me: 50 Leke (pesëdhjetë leke); dhe
 - **Erjola Isa**, e cila ka shlyer kontributin në Shoqëri, në para në shumën e barabartë me: 50 Leke (pesëdhjetë leke);
- 6.3 Bazuar në kontributet e cituara më sipër:
- **Albana Çule**, zotëron një kuotë të barabartë me 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
 - **Erjola Isa**, zotëron një kuotë të barabartë me 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë
- 6.4 Ortakë të Shoqërisë përgjigjen për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.


NENI 7 –TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 7.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8 – ADMINISTRATORI/ËT

- 8.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojnë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 1 (një) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në aktin e emërimit të tij dhe/ose në Statutin e Shoqërisë.
- 8.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë të posaçme (“*ad negotia*”) për kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.
- 8.4 Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:
Erjola Isa, shtetase shqiptare, lindur me 08.10.1990 në Korçë, mbajtëse e letërnjoftimit numër personale J06008091R, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.”

Specimeni i Firmës së Administratorit të Parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër	Nënshkrimi
Erjola Isa	

mbajtëse
es, vendosen
na KOOA " Sh.P.r.

NENI 9 – GJUHA

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.


NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT

10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

Për:

"Optika KOOA " Shpk

ORTAKET THEMELUES:



Albana Çule



Erjola Isa



